

VENDIM
Nr. 703, datë 13.11.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 101, DATË 23.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCIVE PRIVATE TË PUNËSIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 101, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencive private të punësimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit publikon në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve aktin e miratimit, refuzimit dhe revokimit të licencës.”.

2. Në pikën 4, pas fjalëve “... shtetasve shqiptarë jashtë shtetit ...” shtohen fjalët “... dhe të shtetasve të huaj brenda vendit ...”.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Pjesë e dosjes administrative të një punëkërkuesi është dokumentacioni për të dhënat identifikuese të punëkërkuesit dhe të subjektit punëdhënës.”.

4. Pas pikës 6 shtohen pikat 6.1 dhe 6.2, me këtë përmbajtje:

“6/1. Agjencia mban evidenca për ndërmjetësimet e kryera, duke përfshirë dokumentet, si më poshtë vijon:

a) regjistrin, me numrin identifikues përkatës për çdo të ndërmjetësuar;

b) dokumentin identifikues të ndërmjetësuarit;

c) regjistrin me të dhënat identifikuese të subjekteve tregtare përkatëse, që kanë punësuar të ndërmjetësuarin/it.

6/2. Agjencia, gjatë gjithë aktivitetit të saj, duhet të ketë një minimum rezervë sigurie të ngurtësuar, jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë të provueshme nëpërmjet një dokumenti të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari, që mund të përdoret për kompensimet ndaj të tretëve.”.

5. Në pikën 7, pas fjalëve “... trajtim të barabartë për të gjithë punëkërkuesit ...” shtohen “... dhe u nënshtrohet parimeve të përgjithshme, si: parimi i respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut e të drejtave të punës, i ligjshmërisë, i mosdiskriminimit, i sjelljes etike dhe i profesionalizmit, i konfidencialitetit dhe i mbrojtjes së të dhënave personale ...”.

6. Në pikën 8 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Fjala “... pasurisë ...” zëvendësohet me “... sigurisë ...”;

b) Në fund të pikës 8 shtohen fjalët “... si dhe çdo e drejtë e parashikuar nga legjislacioni kombëtar për çështjet e punësimit.”.

7. Pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

“12/1. Agjencia, çdo 6 (gjashtë) muaj, njofton ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit për strukturën, veprimtarinë e vet dhe për ruajtjen e çdo kriteri të licencimit.”.

8. Në fund të pikës 13, fjalët “... ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për revokimin e licencës ...” zëvendësohen me “... ministri përgjegjës për çështjet e punësimit revokon licencën ...”.

9. Pas pikës 18 shtohet pika 18/1, me këtë përmbajtje:

“18/1. Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive publikojnë në faqet e tyre zyrtare të internetit të dhënat për agjencitë private të punësimit të licencuara.”.

II. Dispozitë kalimtare

Për licencat aktive, për nënkategorinë X.2.A, të dhëna para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, brenda afatit kohor prej 120 (njëqind e njëzet) ditësh kalendarike, subjektet kanë detyrimin të aplikojnë për ndryshimet e nevojshme, në përputhje me kriteret e reja, me qëllim mbajtjen e licencës, në të kundërt ajo do të revokohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama